REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

PROJEKT -VENDIM

Nr.___Datë ___.11.2027

"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË BASHKISË SARANDË PËR VITIN 2027"

Bazuar në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , neni 9 ,pika 1/1.3 , gërma b, neni 35, pika 4, neni 54 gërma f, Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , neni 5 gërma b, c dhe ç, neni 7 , neni 9 etj vijim, Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjin.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.132 datë 07.03.2018 "Për metotologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme „ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike , natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësësimit alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar, Udhëzimin nr.15 datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportit rrugor" i ndryshuar, Udhëzimin nr.5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertidikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.85 datë 08.02.2017 "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.970 datë 02.02.2015"Për përcaktimin e proçedurave dhe kushteve për dhënien e liçensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", si dhe legjislacionit të aplikueshëm në fuqi , akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara , me propozim të Kryetarit te Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratohë hartën e përcaktimit të zonave të Bashkisë Sarande dhe Njësisë Administrative Ksamil për efekt të detyrimeve fiskale , sipas shtojces 1 dhe 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore , Drejtoria e Shërbimeve Publike , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të

Territorit , Drejtoria e Financës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Bujqësisë , Veterinarisë, Pyje dhe Kullotave, Drejtoria e Kulturës dhe Shumësporteve dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.143 datë 30.11.2023 "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2024" dhe çdo vendim që bie ndesh me parashikimet e këtij vendimi, shfuqizohen.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETARI
Oltion ÇAÇI
Me urdhër dhe delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

KREU I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky vendim përcakton llojet e taksave dhe tarifave vendore që zbatohen në territorin e Bashkisë Sarandë, nivelin e taksave dhe tarifave, procedurat e llogaritjes, baza tatimore, kategorizimet dhe nën kategorizimet, lehtësimit apo përjashtimit, arkëtimit dhe transferimit në buxhetin e Bashkisë, si dhe detyrimet që kanë agjentët për mbledhjen e taksave dhe tarifave.

Neni 2
Llojet e Taksave

Në zërin Taksa Vendore , konform ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , për Bashkinë Sarandë , përfshihen llojet e tyre si më poshtë

a. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme :
    i. taksa mbi ndërtesat
    ii. taksa mbi tokën bujqësore
    iii. taksa mbi truallin;

b. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
c. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
d. Taksa e fjetjes në hotel;
e. Taksa e tabelës.

Neni 3
Llojet e Tarifave

Në zërin Tarifa Vendore, konform ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , përfshihen llojet e tyre si më poshtë:

Në Bashkinë Sarandë aplikohen tarifat vendore si më poshtë:

a. Tarifa e shërbimeve publike;
b. Tarifa për zënien e hapësirës publike;
c. Tarifa për shërbimet e tjera;
d. Tarifat e parkimit;
e. Tarifat që aplikohen për shërbime të tjera publike;
f. Tarifat që aplikohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
g. Tarifa për dhënien në përdorim të sipërfaqes së plazheve.
h. Tarifa e pasagjerëve të korçerave;

KREU II
TAKSAT VENDORE

Neni 4
Taksa mbi Pasuritë e Paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.Në rastin kurpasuria shfrytëzohet për aktivitetet tregtare kjo taksë do të mblidhet nëpërmjet subjekti tregtar që ushtron aktivitetin e tij në atë pronë, qoftë ky pronari apo subjekt që ka pronën në përdorim për qëllim biznesi.

2. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:
a) taksa mbi ndërtesat;
b) taksa mbi tokën bujqësore.
c) taksa mbi truallin.

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.
Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ngrenë komisionin e verifikimit të
pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

4.1 <u>Taksa mbi Ndërtesën</u>

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Ndërtesë quhet objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesës, sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

Sipas përkufizimit të dhënë nga aktet nënligjore në fuqi për taksën e ndërtesës, objekt taksimi do të jetë çdo ndërtim, që përfaqëson një strukturë ndërtimore dhe në mënyrë të qëndrueshme. Me ndërtim me natyrë të qëndrueshme kuptohet një strukturë e lidhur me tokën, realizimin e së cilës nevojitet procesi i zënies së një sipërfaqe tokë për t'u ndërtuar, që nga elementët e thjeshtë të sistemimit, siç janë hedhja e themeleve, deri në ndërtimin përfundimtar me ngritjen e shtyllave ,kolonave apo trarëve.

4.1.1 Baza e Taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4.1.2 Nilevi i Taksës mbi Ndërtesat

Niveli i taksës mbi ndërtesat në Bashkinë Sarandë është sipas tabelës më poshtë:

Kategoritë e ndërtesave	Vlera e Ndërtesës	Niveli i Taksës
1. Ndërtesa që shfrytëzohen për banim		
a- Bashkia Sarandë	56.000 lekë/m^2	0.05% ndaj vlerës
b- Njësia Administrative Ksamil	56.000 lekë/ m^2	0.05% ndaj vlerës

2. Ndërtesa që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike		
a- Bashkia Sarandë b- Njësia Administrative Ksamil	84.000 lekë/m^2 84.000 lekë/m^2	0.2% ndaj vlerës 0.2% ndaj vlerës
3. Ndërtesa të papërfunduara		
a- Që shërbejnë për banim **b-** Që shërbejnë për veprimtari ekonomike	56.000 lekë/m^2 84.000 lekë/m^2	0.015 % ndaj vlerës 0.06 % ndaj vlerës
4. Ndërtesa dhe ambjente jo banimi		
a- Parkim (garazh) i mbuluar dhe bodrume b- Depo, magazinë për veprimtari industriale **c-** Për veprimtari bujqësore dhe blegtoriale	39.200 lekë/ m^2 28.000 lekë/ m^2 16.800 lekë/ m^2	0.05% ndaj vlerës 0.05 % ndaj vlerës 0.05% ndaj vlerës

* Vlera e ndërtesës për banim të privatizuara me ligjin nr.7652 datë 23.12.1992 "*Për privatizimin e banesave shtetërore*" i ndryshuar do të jetë 39.200 lekë

4.1.3 Përllogaritja dhe Pagesa e Taksës mbi Ndërtesat

Bashkia Sarandë, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues.
Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar.

Bashkia Sarandë, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:
- *Vetëdeklarimi*
Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.Vetëdeklarimi bëhet pranë Bashkisë Sarandë , Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore , për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë.
Mund të merren në konsideratë dhe të përdoren të dhënat e siguruara nga institucione të autorizuara nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e bazës së taksës.
- *Verifikimi në terren*

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njësisë pronësore.Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare,nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuara, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.
Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi. Sipërfaqja e prezumuar nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore,përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:
a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.
Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës.
Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjesvendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës.Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar

4.1.4 Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve

Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë "biznes", strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore , e cila kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës dhe katgorive në tabëlen e cituar më lartë. Detyrimi për taksën e ndërtesës është vjetor.

Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë "familjarë", që kanë kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a , strukturë përgjegjëse do të jetë kjo e fundit si Agjenti tatimor i cili të shpërblehet sipas marrëveshjes përkatëse me Bashkinë Sarandë.Për ata që nuk kanë kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a , atëherë struktura përgjegjëse do të jetë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4.1.5 Mënyra e pagesës së taksës së ndërtesës

Për kategorinë e taksapaguesve biznes, ky detyrim do të jetë vjetor dhe do të paguhet më një këst ndërsa për kategorinë e taksapaguesve familjarë do të paguhet me 12 këste të barabarta , të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, kurse për ata që nuk kanë kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a do të paguhet më një këst të vetëm sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4.1.6 Lehtësira dhe Përjashtime nga Taksa mbi Ndërtesat

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat kategoritë e mëposhtme:

a- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
d- banesat sociale në pronësi të bashkive;
e- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
f- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
g- strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "*brand name*";
h- ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
i- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
j- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse
k- Personat që gëzojnë statusin e invalidit , veteranë të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidë të punës , të verbërit , invalidë paratektraplegjikë e tetraplegjikë , sipas parashikimeve të akteve ligjore për to dhe cdo kategori tjetër e parashikuar shprehimisht në ligje të tjera.

Struktura e ngarkuar për verifikimin e subjekteve që përjashtohen nga pagesa e taksës për kategorinë e subjekteve familjarë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Subjektet familjarë që përjashtohen sipas kësaj pike të këtij vendimi, depozitojnë pranë Bashkisë Sarandë, dokumentacionin përkatës që vërteton se:

a. trajtohen me pension pleqërie ose pension social;
b. janë kryefamiljarë që kanë në përbërje të familjes vetëm pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre të paaftë për punë;
c. trajtohen me ndihme ekonomike;
d. kopje të dokumentit ku banojnë që provon se janë pronarë apo përdorues të pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës etj;
e. kopje të kontratës/ librezës/ faturës së abonentit kryefamiljar që bën kërkesën për përjashtim.

4.2 Taksa mbi Tokën Bujqësore

Tokë bujqësore është kategoria e tokës e cila është përcaktuar si e tillë në sipas regjistrit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

4.2.1 Baza e taksës

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë pronësinë, formularit nr.6 , aktit të pronësisë , çertifikatës së regjistrimit të tokës. Në rast mungese të dokumentacionit ligjor verifikimi bëhet nga komisioni i verifikimit të pasurive të paluajtshme i ngritur për këtë qëllim.

4.2.2 Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Niveli i Taksës mbi Tokën Bujqësore në Bashkinë Sarandë është sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Kategoria e Tokës		Njësia e matjes	Niveli i taksës
1	Kategoria	I	Lekë/ha/vit	5,600
2	Kategoria	II	Lekë/ha/vit	4,900
3	Kategoria	III	Lekë/ha/vit	4,200
4	Kategoria	IV	Lekë/ha/vit	3,600
5	Kategoria	V	Lekë/ha/vit	3,000
6	Kategoria	VI	Lekë/ha/vit	2,400
7	Kategoria	VII - x	Lekë/ha/vit	1,800

4.2.3 Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës

Për vjeljen e taksës së tokës bujqësore, për kategorinë "biznes" dhe për kategorinë "familjarë" strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ose agjenti tatimor i përzgjidhur nga Kryetari i Bashkisë dhe marrëdhëniet me të rregullohen nëpërmjet një kontrate të veçantë i cili do të shpërblehet në masën 5% të shumës së arkëtuar.
Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë Sarandë, për vlerësimin e kategorisë së tokës, verifikimin për kohën e mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, saktësimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) sipas personave , duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashrshme dhe ja përcjell këtë informacion Drektorisë së Taksavë dhe Tarifave Vendore.

4.2.4 Mënyra e pagesës së taksës së tokës bujqësore

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor dhe për të gjitha kategoritë e taksapaguesve ky detyrim paguhet më një këst.

4.2.5 Lehtësira dhe Përjashtime nga taksa e tokës bujqësore

Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore sipërfaqjet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari, për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

4.3 Taksa mbi truallin

Taksa mbi sipërfaqen e truallir në metër katror , në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi apo përdorim përcaktohet sipas dokumentave , që vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Taksa mbi truallin nuk do të aplikohet për kategorinë familjarë , në ato ndërtesa banimi të cilat bëjnë pjesë në kategorinë pallate banimi.

4.3.1 Niveli i taksës mbi truallin

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

Nr.	Kategorizimi sipas qëllimit të përdorimit	Njësia	Niveli i taksës
1	Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m^2/vit	0.56
2	Për qëllime biznesi		20

4.3.2 Mënyra e pagesës së taksës së truallit

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor dhe për të gjitha kategoritë e taksapaguesve ky detyrim paguhet më një këst.

4.3.3 Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës së truallit

Për vjeljen e taksës së tokës bujqësore, për kategorinë “biznes” dhe për kategorinë “familjarë” strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ose Agjenti tatimor i përzgjidhur nga Kryetari i Bashkisë dhe marrëdhëniet me të rregullohen nëpërmjet një kontrate të veçantë i cili do të shpërblehet në masën 5% të shumës së arkëtuar.

Neni 5

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimi.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

5.1 Niveli i Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

Niveli i Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja në Bashkinë Sarandë është sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	Njësia e matjes	Niveli/ Përqindje
1	**Në rastin e ndërtimeve të destinuara për përdorim në sektorin e turizmit , të industrisë , të**		

	ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetiak nga individët		
	Zona A	Vlerë investimi	3%
	Zona B	Vlerë investimi	2%
	Zona C	Vlerë investimi	2 %
2	**Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi ose njësi tregtimi dhe shërbimi , të cilat kryhen nga sipërmarrës dhe/ose shoqëri ndërtimi**		
	Zona A	Çmimi/shitjes/m^2	8%
	Zona B	Çmimi/shitjes/m^2	6%
	Zona C	Çmimi/shitjes/m^2	4%
3	**Ndërtesa në proçes legalizimi**	Vlerë investimi	0,5%
4	**Projekte të infrastrukturës**	Vlerë investimi	0.1%
5	**Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objekte sportive**	Vlerë investimi	1%

5.2 Mënyra dhe Afati i Pagesës së Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

Taksa paguhet dhe ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes së ndërtimit dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi nuk ka paguar dhe ngarkuar aktet që provojnë pagimin e taksës, autoriteti përgjegjës i dërgon kërkuesit, nëpërmjet sistemit elektronik, vendimin për refuzimin e lejes së ndërtimit".

Taksa paguhet nga individi/subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithsesi jo më vonë se 45 ditë nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Nëse subjekti/personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet kamatë 0,1 për qind në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune.

Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit te Territorit dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me leje përdorimi të subjektit.

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

5.3 Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja dhe shkëmbimit të informacionit

Struktura e ngarkuar për llogaritjen e detyrimit , lëshimit të faturës për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe verifikimit të pagesës së kryer nga subjekti , është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Sarandë. Pas kryerjes së kësaj procedurë , subjektet ndërtuese kanë të drejtën të pajisen më „ lejen e ndërtimit". Lidhur me lejet e ndërtimi të dhëna , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit , ka detyrim çdo muaj të informojë me shkrim Drejtorinë e Taksave dhe

Tarifave Vendore me të dhënat përkatëse , që janë „emri mbiemri: emri tregtar i subjektit, NUIS përkatës, numri i kateve të ndërtimit dhe sipëfaqja në metër katror , mbi të cilat do të llogaritet taksat dhe tarifat e tjera përkatësë lidhur me këto subjekte.

5.4 Lehtësira dhe Përjashtime nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

Përjashtohen nga detyrimi i pagesës së kësaj takse, kategoritë e mëposhtme:

a- Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht " *brand name*".
b- Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "*agroturizëm*", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
c- Investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.

Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

6.1 Niveli i Taksës mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme

Niveli i Taksës mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme në Bashkinë Sarandë, është sipas tabelës më poshtë:

	Kategoria	Njësia e matjes	Niveli i taksës
1	Ndërtesa banimi	lekë/m2	300

2	Ndërtesa për tregti dhe shërbime përfshirë dhe zyra	lekë/m2	700
3	Ndërtesa të tjera	lekë/m2	500
4	Për truall e tokë bujqësore	Vlerë shitje	2%

6.2 Vlerësimi dhe Struktura përgjegjëse për vjeljen e Taksës mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme

Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e Agjensisë Shtetërore te Kadastrës , të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë rakordimet me Drejtoria Vendore e Agjensisë Shtetërore e Kadastrës.

6.3 Përjashtime nga Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme

Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a- Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e njësitë e vetëqeverisjes vendore;
b- Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
c- Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, sipas ligjeve në fuqi.

Neni 7
Taksa e Fjetjes në Hotel

Me hotel kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara ne hotel. Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie. Për kategorinë e

subjekteve të cilat deklarojnë me orë pushimi deklarimi deri në tre pushime në ditë të konsiderohet i barasvlershëm me një natë fjetje.

7.1 Niveli i Taksës së Fjetjes në Hotel

Niveli i Taksës së Fjetjes në Hotel në Bashkinë Sarandë paraqitet në tabelën më poshtë:

	Taksa e fjetjes në hotel	Njësia e matjes	Niveli i taksës Bashkia Sarande	Natëqendrimi/dhome
A	Hotele me 4-5	Lekë/natë/qëndrimi/person	175	75
B	Hotel nën 4 yje, motel, hostel , bujtinë si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përckatimeve të ligjit për turizmin			
1	**Zona A**			
	Bashkia Sarandë /NjA Ksamil	Lekë/natë/qëndrimi/person	120	75
2	**Zona B**			
	Bashkia Sarandë /NjA Ksamil	Lekë/natë/qëndrimi/person	90	60
3	**Zona C**			
	Bashkia Sarandë /NjA Ksamil	Lekë/natë/qëndrimi/person	70	40

7.2Mënyra e pagesës së taksës së fjetjes në hotel:

Detyrimi për taksën e fjetjes në hotel i takon klientit, që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evodentohet në faturën e hotelit, në të cilën shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të shënohet vlera e taksës. Subjekti taksapagues ka detyrimin ligjor të kryej pagesën e taksës së fjetjes në hotel brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Kjo pagesë duhet të jetë e barazvlefshme me të dhënat e mbajtura në "Regjistrin e Fjetjes" i çdo subjekti që ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të hotelerisë , duhet të jetë i sekretuar nga Bashkia Sarandë , sipas modelit të miratuar. **Dorëzimi i librit të fjetjes bëhet nëpërmjet protokollimit dhe dorëzimit fizik pranë institucionit të Bashkisë Sarandë për efekt deklarimi të kësaj takse brenda datës 5 muajit pasardhës.**

7.2 Vlerësimi alternativ:

Në rastin kur "Regjistri i Fjetjes" **nuk paraqitet sipas parashikimeve sa më lartë,** atëherë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka të drejtë të bëjë vlerësim alternative, duke marrë për bazë vlerësimin tabelën si më lartë për netën e qëndrimit.

7.3 Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Afati i pagesës është data 5 e muajit pasardhës për subjektet deklaruese dhe data 5 tetor për subjektet e tjera të cilave detyrimi u është maturuar gjatë sezonit veror dhe nuk e kanë deklaruar.

Neni 8
Taksa e tabelës

Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi.

8.1 Baza e taksës së tabelës

Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror , që zë tabela në të gjithë shtritjen e saj. Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet , që duhet të vendosin emërtimin e subjektit e subjektit në pamjet ballor të njësisë ku zhvilojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin ato të lëvishme ose të palëvishme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

8.2 Niveli i Taksës së Tabelës

Niveli i taksës së tabelës në Bashkinë Sarandë do të jetë sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Katergorimi i tabelave	Njësia	Niveli i taksës	
I-	**Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve.** **(ku shënohet emri dhe/ose logoja ose veprimtaria e subjektit)**			
			Niveli 2024	**Niveli 2025**
A -	**Deri në 2 m^2**	**L/m^2/vit**	0	0
B -	**Mbi 2 m^2 deri 10 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim)	L/m^2/vit	10,000	10, 000
	me ndriçim të thjeshtë	L/m^2/vil	15,000	15,000

	elektronike	L/m^2/vit	20,000	20,000
C -	**Mbi 10 m^2 deri 20 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim)	L/m^2/vit	8,500	8, 500
	me ndriçim të thjeshtë	L/m^2/vit	12,750	12,750
	elektronike	L/m^2/vit	17,000	17 000
D -	**Mbi 20 m^2 deri 40 m^2**			
	e thjeshtë (pa ndriçim)	L/m^2/vit	5,500	5, 500
	me ndriçim të thjeshtë	L/m^2/vit	8,250	8, 250
	elektronike	L/m^2/vit	11,000	11, 000
	Mbi 40 m^2			
	e thjeshtë (pa ndriçim)	L/m^2/vit	4,000	4, 000
	me ndriçim të thjeshtë	L/m^2/vit	6,000	6, 000
	elektronike	L/m^2/vit	8,000	8 ,000
II	**Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim.**			
	Tabelë identifikuese	L/m^2/vit	120	120
III	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme, e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m^2.**			
	Tabele e thjeshtë (me/pa/ndryshim)	L/m^2/vit	22,500	22, 500
	Tabelë elektronike	L/m^2/vit	45,500	45, 500
IV	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.**			
	Tabela të të gjitha llojeve dhe përmasave	L/m^2/ditë	1,000	1, 000

8.3 Mënyra e pagesës së taksës së tabelës

Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga Bashkia Sarandë.

8.4 Afati i pagesës

Për kategorinë e I –rë , për subjetet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal , ndërsa për subjetet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 30 qershor, detyrimi llogariete dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit.Në rastin e

më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja , vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë për qëllime identifikuese , ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.

Për kategorinë e II-të subjekete eksistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal , ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet e dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në lejen e dhënë nga Bashkia Sarandë.

Për kategorinë e III-të dhe IV-ërt , detyrimi llogarietet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga struktura përkatëse e Bashkisë Sarandë dhe paguhet paradhënie përpara pajisjes me leje.

8.4 Dhënia e lejes për vendosje tabele për qëllime reklamimi

Në të gjitha rastet, e kërkesës për vendosje të tabelave për qëllime identifikimi dhe reklamimi, të thjeshta dhe elektronike referuar kategorive më lartë, subjekti duhet t'i drejohet me shkrim Bashkisë Sarandë. Drejtoria e Shërbimeve Publike , do të kryej të gjitha procedurat që nga verifikimi , nëse sipërfaqja që kerkohet të vendoset nga subjekti është pjesë e hapësirave publike (në rregulloren për hapësirave publike) ku lejohet vendosja e mundshme të tabelave për qëllime identifikimi dhe reklamimi, të thjeshta dhe elektronike. Më tej , në rastin kur është e mundshme, kryen vlerësimin sipas sipërfaqes së tabelës dhe paguhet paraprakisht , para dhënies së lejes subjektit.

8.5 Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së tabelës

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

KREU III
TARIFAT VENDORE

Neni 9

Tarifa e Shërbimeve Publike

Tarifës së shërbimeve publike i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Sarandës.Në tarifën e shërbimeve publike përfshihet tarifa për pastrimin, gjelbërimin, ndriçimin dhe dekorin.

Për kategorinë e taksapaguesve "Familjarë" tarifat do të aplikohen sipas ndarjes së zonave sipas tabelës së mëposhtme , ndërsa kategoria "Biznes" tarifat do aplikohen sipas llojit të aktivitetit dhe sipas xhiros vjetore, që ata realizojnë, duke marrë për bazë informacionin zyrtar të marrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, për xhiron e realizuar një vit më parë.

Baza e tarifës është llogaritur në nivelin e mbulimit të kostos së shërbimeve të ofruara në të gjithë territorin i cili është nën juridiksionin e Bashkisë Sarandë.

9.1 Niveli i Tarifës së Shërbimeve Publike

Niveli i tarifës së shërbimeve publike, për të gjitha kategoritë, është sipas tabelës më poshtë:

Nr.	KATEGORIA	NIVELI I TARIFËS			
1	**Familjet**				
2	Sarande, Ksamil	5 000			
3	Gjashte, Metoq, Shelegar,Cuke	3 600			
4	**Biznesi**	BV (0-2 mln)	BV (2-8 mln)	BV (8-14mln)	BM
5	**Shitje me Pakice**				
6	Mish, Peshk	7 500	12 000	25 000	40 000
7	Bulmet, Fruta, Perime, Ushqimore	7 500	12 000	25 000	40 000
8	Artikuj industriale (veshje, parfume, argjendari, etj.)	7 500	12 000	25 000	40 000
	Qendra interneti, etj.	7 500	12 000	25 000	40 000
9	Tregtim lendesh djegese, karburant	9 000	18 000	44 000	40 000
10	Ushqimore, Markete e Supermarkete	7 500	18 000	85 000	115 000
11	Shitje produkte farmaceutike	7 500	12 000	25 000	40 000
12	**Shitje me Shumice**				
13	Magazina, dyqane, etj.	7 500	12 000	74 000	94 000
14	Shoqeri tregetare	9 500	18 000	85 000	95000
15	**Njesi Prodhimi**				
16	Perpunim duralum, druri, metalesh, letre, plasmasi, etj	7 500	15 000	25 000	50 000
17	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje etj	7 500	15 000	25 000	50 000
18	Prodhim buke, pasticeri, peshku, bulmeti, etj	7 500	15 000	25 000	40 000
19	Prodhim konfeksione etj.	7 500	15 000	25 000	50 000
20	Prodhim vajrash, nafte, gazi etj	7 500	15 000	25 000	50 000
21	Thertore	7 500	15 000	25 000	40 000
22	Shtypshkronja etj	7 500	15 000	25 000	40 000
23	Impiante per perpunim produkte ushqimore etj	7 500	15 000	25 000	50 000
24	Prodhim Produkte farmaceutike	7 500	15 000	25 000	40 000
25	**Subjekte Ndertimi**				
26	Njesi ndertimi per cdo kantier ndertimi, banim, sherbim, etj	9 500	18 000	95 000	130 000
27	Rikonstruksione te pjeshme	9 500	18 000	95 000	130 000
28	Subjekte ndertuese per seline administrative	9 500	18 000	95 000	130 000
29	Prodhim guri, inertesh, etj.	9 500	18 000	95 000	130 000
30	**Njesi Sherbimi**				
31	Riparim elektro-shtepiake	7 500	11 000	22 000	50 000
32	Fotokopje, berber, sallon bukurie, servis makinash, autoshkolla, agjenci doganore, agjenci turizmi, kembim valute, lavanteri, pastrim kimik, autoshkolla etj	7 500	15 000	50 000	70 000

33	Shtepi botuese, librari, biblioteka	7 500	11 000	22 000	50 000
34	Bar Kafe	12 000	25 000	80 000	130 000
35	Restorant, Fast Food etj.	12 000	25 000	74 000	150 000
36	Pub, Diskoteka, beach bar etj.	25 000	60 000	120 000	200 000
37	Hotele dhe njesi akomodimi Zona A	60 000	110 000	220 000	300 000
38	Hotele dhe njesi akomodimi Zona B	40 000	90 000	190 000	250 000
39	Hotele e njesi akomodimi te tjera	12 000	25 000	60 000	100 000
40	Marangoz, kepucar, rrobaqepes, orendreqes, etj	7 500	15 000	30 000	50 000
41	Komplekse sportive, palestra, fitnes,pishina, qendra einstitute kerkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	12 000	20 000	40 000	70 000
42	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	7 500	15 000	25 000	50 000
43	Institucione jopublike te edukimit, klinika mjekesore e dentare, laboratore	12 000	25 000	50 000	100 000
44	Banka, shoqeri anonime, filaiale te SHA-ve	300 000			
45	Njesi te tjera qe nuk perfshihen me siper	7 500	15 000	30 000	50 000
46	Shoqata, fondacione etj	10 000			
47	Pajisje elektronike te automatizuara ATM	7500 lek/njësi			
48	**Profesione te Lira**				
49	Avokatet, noter,mjek, mjeku-laborant, stomatologu, Farmacisti, ekonomisti kontabël te miratuar, eksperti kontabël te autorizuar, mësuesit, veterinerët, agronomit, botuesit, inxhinier, arkitekti, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njësi fikse apo ne ambiente te ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	7 500	12 500	30 000	50 000
50	Galeritë e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	7 500	10 000	30 000	50 000
51	Kioska te ndryshme	4 000	12 000	30 000	70 000
52	Ambulantë, taksi, tregje publike e private	4 000			
53	Transport mallrash dhe pasagjeresh	3 500	7 000	25 000	48 000

9.2 Mënyra e Pagesës së Tarifës së Shërbimeve Publike

Detyrimi për tarifën e shërbimeve pubike është vjetor.
Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë agjentit tatimor përkatës çertifikatën

e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.
"Për kategorinë I "Familjarët" detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit".
Për kategorinë II. "Biznesi" detyrimi paguhet brenda datë 20 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
Lidhur me aplikimin e tarifës së shërbimeve publike për subjektet e regjistruara rishtaz përgjatë vitit detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB. Subjektet te cilin ushtrojnë aktivitet sezonal (aktivizojnë dhe pezullojnë aktivitetin përgjatë vitit) , të cilët përmbushin vlerën e xhiros së tyre sipas tabelës më lartë, do të paguajnë detyrimet të plota.

Nëse subjekti taksapagues çregjistrohet veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalenderarik fiskal).
Për kategorinë II. "Subjekte Ndërtimi" nënkategorinë "Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj të ngjashëm me to" "Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla kopshte, objekte banimi e tregtare, etj të ngjashëm me to", llogaritja e tarifës se shërbimit do të fillojë me zbardhjen e lejes se ndërtimit deri në momentin e paraqitjes se kërkesës për leje shfrytëzimi pranë Bashkisë së Sarandës.
Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit
Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit duhet të përcjellë informacion lidhur me lejes e ndërtimit dhe llojet e tjera lidhur me ndërtimim , objekt i parashikimeve sa më lartë.
Agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e tarifës së shërbimit për kategorinë "Familjarë" është Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë Sha, duke përfituar 5 % të shumës së arkëtuar, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera (shtetërore dhe private) strukturë e ngarkuar është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

9.3 Lehtësira dhe përjashtimet nga pagesa e tarifës së shërbimeve publike

Kategoritë e përjashtuara nga pagesa e tarifës së shërbimeve publike, ku përfshihen pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbrit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar sipas përkufizimit të ligjit nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Për të përfituar nga ky përjashtim, individët duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Sarandë, dëshminë e gjendjes së tyre:

a. dokumentin që vërteton kushtin që të jenë kryefamiljarë dhe pa persona të tjerë madhorë përveç bashkëshortit ose bashkëshortes, në certifikatën familjare, si dhe persona të tjerë madhorë të paaftë për punë (invalidë ose fëmijë nën 25 vjeç që ndjekin studimet);
b. librezën e veteranit ose invalidit të luftës, statusin e invalidit të punës e të luftës, statusin e të verbrit, të sëmurëve paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit, vërtetimin e KMCAP, vërtetimin nga Njësia Administrative ose lagjja për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Përjashtohen nga tarifa e shërbimeve publike individët fermerë.

Neni 10

Tarifa e Pasagjerëve të Korçerave

Të gjithë pasagjerët e kroçerave që zbresin në portin e Sarandës do t´i nënshtrohen një tarife.
Niveli i tarifës është 50 lekë për pasagjer.
Tarifa vilet nga agjenti tatimor në këmbin të shpërblimit 5 % të shumës së arkëtuar. Agjenti zgjidhet nga Kryetari i Bashkisë. Marrëdhënia me të rregullohet me kontratë të posaçme.

Neni 11

Tarifa për Zënien e Hapësirës Publike

Baza e tarifës për zëniet e hapësirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Hapësirë publike do të konsiderohet çdo hapësirë e cila nuk figuron e regjistruar në pronësi të individit apo biznesit dhe është e aksesueshme nga çdo qytetar apo vizitor.

11.1 Niveli i Tarifës së Zënies së Hapësirës Publike

Niveli i tarifës së zënies së hapësirës publike në Bashkinë Sarandë do të jeë sipas tabelës më poshtë.

Tarifa për Zënie e hapësires publike	Njësia e matjes	Niveli
A. Hapësirë publike në Bulevardin "Jonianët"		
- Përdorim vjetor	Lekë/ m^2/vit	120,000
B. Hapësirë publike në përdorim vjetor		
- Zona A (Sarandë dhe Ksamil)	Lekë/ m^2/muaj	300
- Zona B (Sarandë dhe Ksamil)	Lekë/ m^2/muaj	150
C. Hapësirë publike në përdorim sezonal		
- Zona A (Sarandë dhe Ksamil)	Lekë/ m^2/dite	60
- Zona B (Sarandë dhe Ksamil)		30
D. Hapësire në tregjet publike administruar nga Bashkia		
D.1. Tregu Industrial	Lekë/ m^2/muaj	120
D.2 Tregu i fruta perimeve	Lekë/ m^2/muaj	120

11.2 Dhënia e autorimit për zënien e hapësirës publike

Në të gjitha rastet e përdorimit dhe zënies së hapësirës publike , për të gjitha hapësirat e sipërmendura, subjekti duhet t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Shërbimeve Publike, me kërkesë për leje për shfrytëzim të hapësirës së hapësirës publike. Kjo drejtori do të kryej të gjitha procedurat, që nga verifikimi nëse kjo sipërfaqe që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti, mund të jepet për atë aktivitet që kerkon dhe kryen matjet në

terren të sipërfaqes. Më pas, nëse ky hap kalon , procedura vijon me përgatitjen e vlerësimit tatimor nga Drejtoria e Shërbimeve Publike përllogaritur si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelin tregues të saj, i cili i drejtohet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për të lëshuar faturën për arketim.
Pas marrjes se konfirmimit për pagesën, Drejtoria e Shërbimeve Publike përgatit autorimin për përdorimin e sipërfaqes publike duke përcaktuar kohën dhe objektin përdorimit të hapësirës publike.

11.3 Afati i pagesës

Pagesa për zënien e hapësirës publike, do të bëhet paradhënie, përpara dhënies së autorizimit të zënies së hapësirës publike nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

11.4 Struktura përgjegjëse për vjeljen e Tarifës së Zënies së Hapësirës Publike

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Neni 12
Tarifa për Shërbime të Tjera Publike

Tarifa për Shërbime të tjera përfshin tarifat që aplikohen në përdorimin e një sërë shërbimesh të Bashkisë Sarandë.

Këto tarifa do të vilen nga Strukturat e Bashkisë Sarandë ose Agjenti tatimor në këmbin të shpërblimit 5 % të shumës së arkëtuar.

Agjenti zgjidhet nga Kryetari i Bashkisë. Marrëdhënia me të rregullohet me kontratë të posaçme.

Tarifat që administohen nga Zyra e Protokoll-Arkivi

Nr.	Shërbimi i ofruar	Njësia e matjes	Niveli
1	Për dhënië kopje dokumentacioni nga zyra e protokoll-arkivi për qytetarët	lekë/rast	500
2	Për dhënië kopje dokumentacioni ose informacion për zyra avokatie	lekë/rast	3,500

Tarifa që administrohen nga Zyra e Gjendjes Civile

Nr.	Shërbimi i ofruar	Njësia e matjes	Niveli
1	Lëshim vertetimi (banimi, ndryshim emri etj)	lekë/rast	100

Tarifa që administrohen nga Drejtoria e Kulturës dhe Shumësporteve

Nr.	Kategoria	Njësia e matjes	Niveli
1	Tarifë për përdorim sallës së kinoteatrit	lekë/rast	10,000
	Tarifë për përdorim i kompleksit sportiv "Aleko Dajko"		
	-Për aktivitete fitimprurëse (koncerte, spektakël etj).		20,000
	-Për aktivitete jo-fitimprurëse, politike, sociale.		10,000
2	-Për stërvitje, trajnim.	lekë/rast	500
	Tarifë për përdorim të stadiumit të futbollit		
	Për përdorim për evente , koncerte etj		50.000
	Për ndeshje zyrtare ndërmjet ekipeve të të rriturve.		
	-Ekipe të huaja jo rezidenciale		100,000
	-Ekipe Superligë		50,000
3	-Ekipe kategoria e I-II	lekë/rast	30,000
	Tarifë për aktivitete parapërgatitore në stadium		
	-Ekipe të huaja jo rezidenciale		50,000
	-Ekipe Superligë		20,000
4	-Ekipe kategoria e 1-11	lekë/ekip/seancë	10,000
5	Tarifë përdorimi të stadiumit të futbollit nga Subjekte private për qëllim stërvitje mësimore me fëmijë nën 16 vjeç	lekë/muaj/ ekipi	5.000
6	Tarifë për lojë në fusha të minifutbollit	lekë/lojtar	200
7	Tarifë për lojë në fusha të basketbollitt	lekë/lojtar	50
8	Tarifë për biletë hyrje në kinoteater	lekë	100
9	Tarifë për biletë hyrje në muze dhe Galerinë e Artit	lekë	100
	Tarifë për biletë hyrje në stadiumin e futbollit		
	-Tribuna VIP		400
	-Tribunat qëndrore		200
10	-Shkallët anësore dhe përballë	lekë/person	100

Tarifat që administrohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike , paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	
1	Për lëshim autorizime të ndryshme	Lekë/autorizim	500
2	Për autorizim për ndërhyrje të autorizuar në rrugë e trotuare nga qytetarë e subjekte të ndryshme për nevojat e tyre	Lekë/m^2	12,000
3	Për autorizim për zënie e hapësirës publike për ngritje kantieri për objekt gjatë ndërtimit	Lekë/m^2/ditë	50
4	Për përdorim të autorizuar të rrugës dhe pjesëve të saj si dhe mjedise të tjera publike	Lekë/orë pune	1,000
8	Leje ushtrim aktiviteti "non stop" , 24 orë	Lekë/vit	20,000
9	Autorizim për lëvizje në kundërshtim me sinjalistike, me orar të përcaktuar.	Lekë/rast	5,000
11	Tarifë shërbimi për rrjetin telefonik, TV Kabllor, internet a)në linjat ajrore b)në linjat nëntokësore	 Lekë/km/vit	 2,000 Lekë/km/vit 1,500
12	Tarifë: për përdorimin e platformave pluskuese në det Për organizimin e lojërave të ujit.	Lekë/m^2/sezon	40
13	Tarifat: shërbimi për punime elektrike në lartësi me automjet të Bashkisë për të tretë.	Lekë/orë	4,000
14	Tarifë për ankorimin e mjeteve lundruese për shërbime turistike	Lekë/sezon	
	-Jetski	Lekë/sezon	10,000
	-Motoskafë deri 25 c	Lekë/sezon	6,000
	-Motoskafë mbi 25 c	Lekë/sezon	10,000
	-Velierë e mjete të tjera turistike (tarifë ankorimi)	Lekë/m.linear/ gjerësi/ ditë	580
15	Tarifë depozitimi i mbetjeve inerte nga ndërtimet	Lekë/m^3	150
16	Tarifë		

Në kuptim të pikes 12, në tabelë, baza e tarifës për linjat ajrore dhe nëntokësore, është gjatësia lineare për kilometër të linjave ajrore dhe nëntokësore, të cilat vihen në shfrytëzim nga

subjektet për qëllime biznesi dhe aplikohet vetëm për rastet kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore pronë e bashkisë. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare) me nivelin e saj.

Në kuptim të pikes 16, në tabelë, për administrimin e tarifës të depozitimit të mbetjeve inerte, ngarkohen lnspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Subjektit që ka marrë lejen e ndërtimit, leja e fillimit të punimeve nga IMT-ja i jepet pasi ka marrë nga Drejtoria e Shërbimeve autorizimin, ku përcaktohet vendi dhe sasia e mbetjeve inerte që do depozitohen, shoqëruar me pagesën e tarifës, mbi bazën e faturës për arkëtim, që do të lëshohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Tarifat për reklamim në Led-ëall të Bashkisë Sarandë

Nr.	Kohëzgjatja e reklamimit	Afati i reklamimit 1 javë	Afati i reklamimit 1 muaj	Afati i reklamimit 3 muaj
1	15 Sek	1.000 lekë	3.500 lekë	9.500 lekë
2	20 Sek	1.500 lekë	5.500 lekë	15.500 lekë
3	25 Sek	2.000 lekë	7.500 lekë	21.500 lekë
4	30 Sek	2.500 lekë	9.500 lekë	27.500 lekë
5	35 Sek	3.000 lekë	11.500 lekë	33.500 lekë
6	40 Sek	3.500 lekë	13.500 lekë	39.000 lekë

Subjektet e interesuara për reklamim pranë Led-ëall -in e Bashkisë Sarandë të ndodhur në hyrjen e qytetit, do të duhet të paraqesin kërkesën e tyre pranë Bashkisë Sarandë. Pasi trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe kryejne pagesën përaktës, kjo e fundit e përcjellë pranë sektorit TIK për realizimin e shërbimit sipas kohëzgjatjes përkatëse.

Tarifa që administrohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	
1	Tarifë shërbim varimi për shoqeritë e liçensuara	lekë/rast	5,000
2	Tarifë shërbimi për ndërtim, rikonstruksion, veshje varresh për subjektet që kryejnë këtë shërbim	lekë/rast	2,000

Për tarifat e përcakruara në pikën 1 dhe 2 të kësaj tabele ngakrohet Ndërmarja e Shërbimeve Publikë të kryej administrimin e tyre duke koordinuar në bazë mujore me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore e cila ngarkohet për vjeljen e tyre nga subjektet përkatëse.

Tarifa që administrohen nga Drejtoria e Bujqësisë, Veterinarisë, Pyje dhe Kullotave

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vlera
1	Tarifë: per ujitje për sezon	Lekë/per dynim	300

Për administrimin e tarifës të ujitjes për sezon, ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Veterinarisë, Pyje dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vlera
1	Tarifë për përdorim të shezlongëve në plazhet që administrohen nga Bashkia	Lekë/shez	200
2	Tarifë për përdorim të çadrave në plazhet që administrohen nga Bashkia	Lekë/Çadër	300

Për administrimin e tarifës për përdorim të shezlongëve në plazhet që administrohen nga Bashkia do të përcaktohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

12.1 Lehtësira dhe Përjashtime nga Tarifat për Shërbimet e Tjera

Në pikën 1 të tabelës së paraqitur për Tarifat që administrohen nga Zyra e protokollit -arkivit, përjashtohen pensionistët, familijet që përfitojnë ndihmë ekonomike si edhe veteranë kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidë të punës, të verbërit, invalidë paraplegjikë fitojnë këtë status në bazë të ligjit nr.7874,datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër nazifashistë të popullit shqiptar" i ndryshuar, ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit".

Nga pikën 7 dhe 8 e tabelës së paraqitur për Tarifat që administrohen nga Drejtoria e Kulturës dhe Shumësporteve përjashtohen moshat nën 18 vjeç.
Nga pika 9 dhe 10 të tabelës së paraqitur Tarifat që administrohen nga Drejtoria e Kulturës dhe Shumësporteve përjashtohen fëmijët e ciklit 9- vjeçar dhe parashkollorët.

Neni 13

Tarifat e Parkimit

Zonat , sheshet dhe rruget e lejuara për parkim, për t'u përdorur për parkim, do të jenë kornform standarteve dhe legjislacionit përkatës në fushën e qarkullimit rrugor. Është Drejtoria e Shërbimeve Publike , struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe përcaktimin e hapësirave për parkim.

Tarifat e parkimit përfshijnë:

a. Tarifat e parkimit në sheshe;
b. Tarifat e parkimit në rrugë;
c. Tarifat e parkimit në terminale;
d. Tarifat e parkimit për mjete të veçanta (taksitë, autobusat, mjetet e tonazhit të rëndë, etj.).

Me qëllim implementimin e tarifave të parkimit, territori i Bashkisë Sarandë ndahet në dy zona tarifore, zona A dhe B, sipas hartës së më poshtme.

13.1 Tarifat e Parkimit në Sheshe

Në sheshet e parkimit të administruara nga Bashkia Sarandë aplikohen tarifat e mëposhtme:

Intervali Kohor	Tarifa/Zona A	Tarifa/Zona B
0-3 Orë	150 Lekë	100 Lekë
3-8 Orë	400 Lekë	200 Lekë
8-12 Orë	550 Lekë	300 Lekë
12-24 Orë	800 Lekë	400 Lekë

Për parkimin e rezervuar në sheshe, aplikohen tarifat e mëposhtme.

Paketa	Orë/Ditë	Zona A	Zona B
Abonim 1 mujor	8	6,000 Lekë	3,000 Lekë
Abonim 3 mujor	8	15,000 Lekë	7,500 Lekë
Abonim 6 mujor	8	28,000 Lekë	14,000 Lekë
Abonim 12 mujor	8	55,000 Lekë	28,000 Lekë

13.2 Tarifat e Parkimit në Rrugë

Tarifat e parkimit me pagesë në rrugë, janë si më poshtë.

Zona	Lekë/Orë
Zona A	100
Zona B	50

Rrugët që do të miratohen për tu aplikuar tarifat e mësiperme janë:

a) Rruga "Abedin Dino"
b) Rruga "Flamuri"

c) Rruga “Turizëm Kanali i Cukes”
d) Rruga “Mit”hat Hoxha”

Tarifat e parkimit të rezervuar në rrugë, me kontratë 1 vjeçare janë si më poshtë.

Paketa	Orë/Ditë	Zona A	Zona B
E Hënë – E Premte	12	90,000 Lekë	45,000 Lekë
E Hënë – E Diel	24	150,000 Lekë	75,000 Lekë
E Hënë – E Diel	12	110,000 Lekë	55,000 Lekë
E Hënë – E Premte	10	80,000 Lekë	40,000 Lekë
E Hënë – E Diel	10	100,000 Lekë	50,000 Lekë

13.3 Tarifat e Parkimit në Terminale

Në terminalet e përhershme apo të përkohëshme të administruara nga Bashkia Sarandë, aplikohen tarifat e mëposhtme.

Intervali Kohor	Tarifa/Zona A	Tarifa/Zona B
Furgon dhe mikrobuzë		
1 Orë	80 Lekë	40 Lekë
1-3 Orë	150 Lekë	75 Lekë
3-8 Orë	350 Lekë	175 Lekë
12-24 Orë	550 Lekë	275 Lekë
Autobus deri 32+1 vende		
1 Orë	100 Lekë	50 Lekë
1-3 Orë	200 Lekë	100 Lekë
3-8 Orë	400 Lekë	200 Lekë
12-24 Orë	600 Lekë	300 Lekë
Autobus nga 32+1 deri 42+1 vende		
1 Orë	150 Lekë	100 Lekë
1-3 Orë	300 Lekë	150 Lekë
3-8 Orë	500 Lekë	250 Lekë
12-24 Orë	700 Lekë	350 Lekë
Autobus mbi 42+1 vende		
1 Orë	200 Lekë	150 Lekë
1-3 Orë	400 Lekë	200 Lekë
3-8 Orë	600 Lekë	300 Lekë
12-24 Orë	800 Lekë	400 Lekë

13.4 Tarifat e Parkimit për Mjete të Veçanta

Për kategoritë e mjeteve të veçanta aplikohen tarifat si më poshtë.

Nr.	Tarifë shërbimi për parkimin e automjeteve	Njësia matjes	Niveli

1	Autovetura Taksi	Lekë/vit	3, 000
2	Automjet transport malli deri 3.5 tonë	Lekë/vit	3, 000
3	Autobus I lehte deri 32+1 vende	Lekë/vit	3 ,000
4	Autobus i mesem nga 32+1 -42+1 vende deri 32+1 vende	Lekë/vit	3, 000
5	Autobus I rende mbi 42+1 vende	Lekë/vit	5, 000
6	Autobus vend parkim i miratuar	Lekë/ore	100
7	Automjet transport malli mbi 3.5-8 tonë	Lekë/vit	5, 000
8	Automjet transport malli mbi 8-14 tonë	Lekë/vit	6, 000
9	Automjet transport malli mbi 14 tonë	Lekë/vit	8, 000
10	Makina të rregjistruara në nipt.	Lekë/makinë/vit	1.000
11	Motorra të rregjistruara në nipt.	Lekë/motorra/vit	500

13.5 Dhënia e lejes së parkimit të rezervuar

Në të gjitha rastet e kërkesave për leje të parkimit të rezervuar , subjektet duhet ti drejtohen Drejtorisë së Shërbimeve Publike , me kërkesë. Kjo drejtori do të kryej të gjitha procedurat, që nga verifikimi nëse kjo sipërfaqe që kërkohet mund të jepet për përdorim parkimi të rezervuar. Në rast se subjekti kualifikohet , vijon me përgatitjen e vlerësimit tatimor nga Drejtoria e Shërbimeve Publike përllogaritur me nivelin tregues sipas tabelës sipërtreguar, i cili i drejtohet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për të lëshuar faturën për arketim.
Pas marrjes se konfirmimit për pagesën, Drejtoria e Shërbimeve Publike përgatit lejen për parkim të rezervuar.

13.6 Afati i pagesës

Pagesa për parkimin e rezervuar do të jetë paradhënie , përpara dhënies së lejes nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Për pjesën tjerër të tarifave të tjera të parkimit, Kryetari i Bashkisë do të vendos lidhur me agjentin i cili do të ngarkohet për vjeljen e tyre.

13.7 Struktura përgjegjëse për vjeljen e Tarifës së Parkimit

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Policia Bashkiake.

Neni 14

Tarifat për Çertifikimin dhe Liçensimin e Transportit të Udhëtarëve dhe mallave

Çertifikata dhe Liçensa janë dokumente vërtetues të llojit të aktivitetit të subjektit , të cilat lëshohen nga Bashkia Sarandë.

14.1 Niveli i tarifës

Për liçencat dhe çertifikatat që lëshohen në fushën e transportit rrugor aplikohen tarifat e mëposhtme.

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa në lekë	
I	**TRANSPORT UDHËTARËSH**		Afati 10 vjet	Afati 5 vjet
	Brenda vendit			
1	Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt qytetëse të udhëtarëve.	Për linjë	80000	=
	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Për mjet	=	5000
2	Liçencë për kryerjen e shërbimeve në linjë të rregullt rrethqytetëse të udhëtarëve	Për linjë	40 000	=
	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse.	Për mjet	=	7 500
			Afati 5 vjet	
3	Liçencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Për linjë	20 000	
	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të udhëtarëve	Për mjet	7 500	
4	Liçencë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerës) të udhëtarëve	Për linjë	20 000	
	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve	Për mjet	7 500	
5	Çertifikatë për transportin e udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit.	Për mjet	7 500	
6	Liçencë për transport udhëtarësh me taksi	Për mjet	20 000	
II	**TRANSPORT MALLRASH**			
	Brenda vendit			
1	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.	Për liçencë	40 000	

	Çertitikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit.	Ton /kapac	100*
2	Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	Ton/ kapac	100*
3	Çertifikatë për tërheqës	Për tërheqës	7 500
III	**SHËRBIME TRANSPORTI**		
1	Licencë për agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit.	Për licencë	15000
2	Licensë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh	Për licencë	40000

Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie, paguhet 30% e vlerës së plotë.
Për rastet e ndryshimeve në licencë/çertifikatë, që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30 % e vleftës së plotë.

14.2 Baza e tarifës

Niveli i tarifave është i përcaktar sipas legjislacionit në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , referuar ligjit 8308 datë 18.03.1998 "Për transportete rrugpre" i ndryshuar, udhëzimit nr.15 datë 24.07.2007 " Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave , autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" i ndryshuar, udhëzimin nr.5627 datë 18.11.2016 " Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentscionit për lëshimin e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" i ndryshuar.

14.3 Struktura përgjegjëse për hartimin e kritereve , faturimin dhe vjeljen e tarifës

Struktura përgjegjëse , lidhur me aplikimet e subjekteve për t'u pajisur me Çertifikatat dhe Liçensat e sipërmendura , do të jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike . Kjo drejtori do të kryej të gjitha procedurat, që nga verifikimi përmbushjes së kritereve dhe dokumentacionit përkatës. Në rast se subjekti kuaalifikohet, vijon me përgatitjen e vlerësimit tatimor nga Drejtoria e Shërbimeve Publike përllogaritur me nivelin tregues sipas tabelës sipërtreguar, i cili i drejtohet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për të lëshuar faturën për arketim.
Pas marrjes se konfirmimit për pagesën, Drejtoria e Shërbimeve Publike përgatit Liçensën ose Çertifikatën e Transportit të Udhëtarëve dhe mallrave sipas formatit ligjor.

Neni 15

Tarifa për dhënien e Liçensave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve , Gazit të lëngshëm, të Naftës për automjetet , Vajrave Lubrifikatë dhe Lëndëve djegëse për përdorim konsumatorë fundorë

15.1 Baza e tarifës

Niveli i tarifave është i përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.970 datë 02.12.2015 " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" , i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.344 datë 19.04.2017.

15.2 Niveli i tarifës

Niveli i tarifës për dhënien e Liçensave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve , Gazit të lëngshëm, të Naftës për automjetet , Vajrave Lubrifikatë dhe Lëndëve djegëse për përdorim konsumatorë fundorë, do të jenë si më poshtë:

Nr.	Kategoria	Njësia	Niveli i tarifës
1	Për dhënien dhe rinovimin e liçensave për stacion të shitjes së karburanteve, gazit të lëgshëm dhe të naftës për automjetet	Lekë/Liçensë/ 5 vjet	1.000.000
2	Për dhënien dhe rinovimin e liçensave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse , që ushtronë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorë fundorë	Lekë/Liçensë/ 5 vjet	100.000

Neni 16

Tarifa që aplikohen nga Drejtoria e Planifikimi dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit aplikohen tarifat si më poshtë:

Nr	Emërtimi i tarifës	Njësia e matjes	Niveli tarifës
1	**Kontrolli i fazave të punimeve të ndërtimit**		
a	Piketimi i objektit: Objekte deri në tre kate	lekë	4,000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6,000
b	Përfundimi i kuotës +0.00 m të objektit		
	Objekte deri në tre kate	lekë	4,000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6,000
c	Përfundimi i karabinasë së objektit		
	Për çdo kat	lekë	3,500

d	Përfundimi i sistemimit të jashtëm		
	Objekte deri në tre kate	lekë	4,000
	Objekte mbi tre kate	lekë	6,000
e	Kontroll për lejen e shfrytëzimit		
	Sipërfaqe për banesë	lekë/m^2	50
	Sipërfaqe për biznes	lekë/m^2	70
2	**Për pajisje me leje të re ndërtimi**	lekë	10,000
3	**Rifreskim leje ndërtimi**	lekë	10,000
4	**Për studim urbanistik**		
	Nën 300 m^2 (parcela)	lekë	8,000
	Mbi 300 m^2 (parcela)	lekë	10,000
5	**Planimetri shesh ndërtimi**		
	Nën 300 m^2 (parcela)	lekë	8,000
	Mbi 300 m^2 (parcela)	lekë	1,0000
6	**Piketim shesh ndërtimi**	lekë/m^2	25
7	**Lëshim dublikate dokumenti**	lekë	8,000
8	**Leje për prishje objekti**	lekë	8,000
9	**Leje për prerje drurësh**	lekë	4,000
10	**Tarifë për pajisje me autorizim për punime të brendshme ndërtimi (rikonstruksione)**	vlerë punimi	2%
11	**Tarifë për shërbimin ndaj personave që kërkojnë rregjistrimin e pasurive (banesave) të ndërtuarapërpara datës 10.08.1991**	lekë/rast	10,000
12	**Tarifë aplikimi në sistemin elektronik**		
	- për ndërtime deri në 250 m^2	lekë/rast	4,000
	- për ndërtime mbi 250 m^2	lekë/rast	10,000
13	**Tarifë aplikimi për punime me deklarim paraprak**	lekë/rast	2,500
14	**Tarifë për kantjerin**	lekë/rast	4,000
15	**Tarifë për përpunimin e fasadave dhe rifiniturës**	lekë/rast	5,000

Neni 17

Tarifa për Dhënien në Përdorim të Sipërfaqes së Plazheve

Kjo tarifë mbulon shërbimin e dhënies në përdorim e hapësirës publike, me qëllim vëndosjen në shërbim të komunitetit të shezlogeve të plazhit, çadrave, dhomave të zhveshjes, dusheve, shërbimeve higjenike, impianteve dhe pajisjeve për përgatitjen e pijeve dhe ushqimeve, si dhe për kryerjen e veprimtarive të tjera të turizmit ujor.

Niveli i tarifës është 800 Lekë/m2/sezon.

Sezon do të konsiderohet e gjithë periudha që subjektet kryejnë veprimtari stacion plazhi në përputhje me aktin nënligjor përkatës që rregullon veprimtarinë e stacionit të plazhit, pavarësisht kohës së nënshkrimit të kontratës për mbajtjen hapur të stacioneve të plazhit.

Për administrimin e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Neni 18

Penalitetet

Për moslikuidimin në afatin e përcaktuar të detyrimit për taksat e tarifat, subjektet që ushtrojnë biznes, paguajnë kamatëvonesa, në shumën 0,06% të detyrimit për çdo ditë vones, por jo më shumë se 25% të detyrimit të vitit ushtrimor.

Afati i fundit për pagesën e detyrimeve të vitit ushtrimor, për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave, është data 31 Dhjetor i çdo viti. Pas kësaj date, fillon llogaritja e kamatëvonesave për ditë kalendarike.

Neni 19

Dispozitat e fundit

Për efekt të indetifikimit të subjekteve të taksave dhe tarifave vendore për llogaritjen e detyrimeve fiskale dhe kategorimin e tyre në zonat përkatëse sipas hartas bashkëlidhur këtij vendimi do të jetë si më poshtë:

a- Në Zonën A do të përfshihen të gjithë subjektet në sipërfaqen e paraqitur në hartë si zonë A dhe subjektet që prekin brezin e parë të kufirit ndarës për të cilët do të aplikohet tarifa me e lartë midis dy zonave

b- Në Zonën B do të përfshihen të gjithë subjektet në sipërfaqen e paraqitur në hartë si zonë B dhe subjektet që prekin brezin e parë të kufirit ndarës për të cilët do të aplikohet tarifa me e lartë midis dy zonave

c- Zona C do të përfshihen të gjithë subjektet në sipërfaqen e paraqitur në hartë si zonë C